




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPSTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	66/18
Nr. i fq. / Br. st	- 7 -
Data: / Datum	14. 03. 2018
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e -I-rë e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më
12 shkurt 2018 në sallën e Kuvendit të Komunës, e cila filloi në ora 14:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli - Latifi, Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka, Lutfi Bilalli dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (Kryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Afrim Namani, Lutfi Gërguri, Sedat Rashica, Sylejman Meholli), Idriz Muzaqi, udhëheqës i zyrës ligjore, nga sekretaria e kuvendit: Haki Maloku, Bastri Duraku, Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ai deklaroi se kanë ardhur disa propozime që të futen në rend të ditës:

- Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të komunës lidhur me emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) Nr. 23/18, dr. 25.01.2018;
- Propozim-vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
- Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë në strehim.

a) Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha se vendimi për emërim të anëtarëve të KPF-së na është kthyer nga MAPL sepse është në kundërshtim me Ligjin për Barazi Gjinore, për shkak të “mospërfaqësimit të barabartë të femrave në këtë trup ndihmues të punës së kuvendit”. Sipas ligjit kërkohet që të arrihet përfaqësimi minimal prej 50% për secilën gjini. Në fund tha se 19 komunave iu është dërguar kjo shkresë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – theksoi se përderisa MAPL e ka kthyer vendimin se nuk është në harmoni me dispozitat ligjore dhe kërkohet që të plotësohet ai vendim, atëherë ne si KPF nuk jemi në harmoni me ligjin dhe nuk ka arsye që të vazhdojë mbledhja, në ç’rast tha se nuk është dashur të thirret fare kjo mbledhje, sepse vendimet tona nuk janë të vlefshme. Ai kërkoi që kjo mbledhje të shtyhet, pasi që në njëfarë forme po mbajmë mbledhje të jashtëligjshme.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se institucionet qendrore nuk e kanë të rregulluar përfaqësimin gjinor në qeveri, kuvend, madje në ministrinë e vet (MAPL), kurse në anën tjetër kërkojnë nga komunat që ta respektojnë përfaqësimin gjinor.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se të diskutojmë ne si KPF, e rekomandojmë për kuvend dhe kuvendi vendos lidhur me këtë çështje.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – tha se duhet të respektohet Ligji për Barazi Gjinore.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se Ligji për Barazi Gjinore duhet të respektohet në të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, madje edhe në ekzekutivin komunal, e jo të kërkohet zbatim të ligjit në mënyrë të njëanshme. Ligji për Barazi Gjinore nuk thotë që është obligim të krijohet përfaqësim gjinor, por kërkohet që të arrihet përfaqësimi gjinor. Klinaku tha se do të ishte mirë të kërkohen sqarime nga MAPL të na tregojnë se cili është 50% i numrit 9?

Idriz Muzaqi, udhëheqës i zyrës ligjore – deklaroi se me vendim të MAPL-së nuk është anuluar vendimi i kuvendit të komunës, është kërkuar që të rishqyrtohet. Prandaj, është e drejtë e kuvendit të komunës se si të veprojë, e jo KPF-ja. Ai theksoi se nuk sheh pengesa që të vazhdojnë punimet e KPF-së, sepse nuk është një organ vendimmarrës, por është një organ këshillues, i cili i procedon materialet për kuvend. Prandaj, kuvendi i komunës në seancën e radhës mund të deklarohet lidhur me këtë vendim.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri rekomandoi që të procedohet në kuvend.

b) **Haki Maloku, udhëheqës i sekretarisë** - kërkoi që të mos futet në rend të ditës “Propozim-vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)”, pasi që propozimet që gjenden në këtë propozim-vendim i kemi marrë pa na e dërguar njoftimin nga MAPL-ja që të respektohet kriteri gjinor. Prandaj, me qëllim që të arrihet kriteri gjinor do t’i presim propozimet e reja dhe nëse nuk arrijmë t’i kompletojmë deri në kuvend këto propozime, do të shtyhet për mbledhjen e muajit mars.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha që nuk ka asgjë të pamundshme nëse e procedojmë në kuvend themelimin e KKSB-së, kurse ka kohë të mjaftueshme për marrjen e propozimeve.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i zyrës ligjore – deklaroi se neni 4 që ka të bëjë me kompensimin duhet të plotësohet dhe të harmonizohet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike (neni 80), ku shërbyesit civilë nuk kanë të drejtë të marrin kompensim shtesë për pjesëmarrje në komisione apo autoritet tjetër publik.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri rekomandoi që të plotësohet neni 4 lidhur me kompensimin dhe nëse Zyra e Kryetarit arrin që të sigurojë propozimet për arritjen e kuotës gjinore të procedohet për kuvend, nëse nuk arrin t’i sigurojë propozimet shtyhet për mbledhjen e radhës.

c) **Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së** – deklaroi se pasi që ka ardhur kjo kërkesë ne mund ta rekomandojmë për kuvend apo drejtorisë kompetente.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha që ndoshta kishte me qenë më mirë sikur ta rekomandonim në drejtori, në mënyrë që drejtorja ta analizojë situatën reale në terren.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri rekomandoi që Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ta analizojë situatën reale në terren.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – kërkoi që pika e 3-të “Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, sepse si material nuk ka ardhur i kompletuar, pasi që nuk janë pasqyruar tabelat e të hyrave (burimet nga kanë ardhur). Pra, të sqarohet se nga cili pozicion kanë ardhur këto mjete.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – kërkoi që të bëhet ndërrimi i këtyre, pikës 2 “Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2018 me pikën 3 “Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018, pasi siç tha ai pas konsultimit me kryetarin dhe drejtorin e financave u pajtuam që të ndryshohet renditja e këtyre pikave.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – u pajtua që pika 2 të ndërrohet me pikën 3, pasi siç tha ai nuk ka kuptim që pika 2 të jetë para pikës 3. Lidhur me atë që e tha Zhegrova, pajtohem sepse ka të drejtë, pasi që në shumë komuna vendosen kodet dhe nënkodet. Pra, për kuvend mund të plotësohen të dhënat, tha ai.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- deklaroi se lidhur me bartjen e të hyrave është e vërtetë që nuk ceken burimet se nga kanë ardhur, por të gjitha projektet që kanë mbetur gjysmë janë plotësuar dhe mjetet që kanë tepruar i kemi vendosur në këtë.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri u pajtua që të bëhet ndërrimi i pikës 2 me pikën 3.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – lidhur me pagën theksoi se është bërë një gabim ose nga sekretaria ose nga Drejtoria e Financave, sepse në vend që t’i hedhin 200 euro, më janë hedhur 800 euro. Prandaj, të sqarohet se pse ka ndodhur ky gabim.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- theksoi se ky gabim është bërë nga menaxheri i personelit, i cili tek ne në drejtori e sjelli për ta korrigjuar.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2018;

4. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen në shëndetësi;
5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018;
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2017;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve;
8. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha që sot kemi biseduar me përfaqësuesit e komunitetit serb dhe kemi kërkuar që ta sjellin propozimin nga komuniteti serb me emër të një femre për ta plotësuar kriterin gjinor.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha që pika 1.4 e këtij propozim-vendimi “subvencione dhe transfere”- 55 mijë euro duhet të shkojë në kuvend dhe të votohet, mirëpo është edhe afati ligjor për hyrjen në fuqi. Në vazhdim pyeti se mos po rrezikojmë me këtë të na kthehet nga MAPL si e kundërligjshme?

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- deklaroi se kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Financave në kundërshtim me kriteret e tyre, për të mirën e komunës. Prandaj, nëse kuvendi e voton dhe na kalon kjo çështje në ministri në rregull, nëse jo e destinojmë për ndonjë çështje tjetër.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – sugjeroi që në të ardhmen mos të bëhen eksperimente “nëse na e pranojnë është në rregull” si në “bastore”. Ai tha se drejtoria duhet të jetë më vigjilente dhe në kuvend të marrim vendime të ligjshme.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – pyeti edhe njëherë se, cili është burimi i këtyre të hyrave; Cili është destinimi i tyre.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- deklaroi se këto janë mjete të pashfrytëzuara nga viti i kaluar dhe është problem të dihet burimi i të ardhurave, sepse krejt mjetet e pashfrytëzuara bashkohen në një vend.

Fjolla Ujkani, anëtare e KPF-së – propozoi që në shkollën fillore “Martirët” në Reznik të planifikohen mjete për ndërtimin e një terreni sportiv, për të cilin propozim tha se do ta bëjë edhe në kuvend.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2018.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- sqaroi se janë bërë dy gabime teknike: tek pika “ndihmë për shërim” duhet të jetë 24.000.00 euro e jo 24.00.00 dhe tek pika “financim të OJQ-ve” duhet të jetë 25.000.00 euro e jo 25.00.00.

Haki Maloku, udhëheqës i sekretarisë- propozoi që tek pikat: 2.5 financim të OJQ-ve dhe 3.3 financimi i OJQ-ve, të ndahet një shumë për raste të veçanta (shuma të vogla të mjeteve deri në 500 euro).

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – tha që nuk pashë që janë ndarë mjete për klubet sportive. Ai kërkoi që të hiqet pika 5 “mjetet e bartura (subvencionet) nga viti 2017” dhe nëse ministria e aprovon këtë shumë prej 55.000.00 euro, në seancën e radhës e aprovojme në kuvend, në mënyrë që mos ta rrezikojmë edhe vendimin e subvencioneve.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- sqaroi se pika 3.3 financimi i OJQ-ve është për klubet sportive dhe ka ndryshuar forma e financimit. Tash e tutje duhet të shkohet sipas procedurave me shpallje të konkursit.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – theksoi se qëllimi i mjeteve të bartura është që t’iu japim përkrahje rinisë dhe shëndetësisë. Mjetet që do të barten në vlerë prej 55.000.00 euro, prej tyre 30.000.00 euro do të shkojnë në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, kurse 25.000.00 euro në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen në shëndetësi.

Sylejman Mehulli, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – sqaroi se informata për gjendjen në shëndetësi ka qenë e paraparë që të shqyrtohet në nëntor të vitit 2017 me Plan të punës së kuvendit. Mirëpo, për shkak të zgjedhjeve që u mbajtën në tetor, kuvendi nuk ka funksionuar që nga muaji shtator i vitit 2017. Ai theksoi se në bashkëpunim me Qendrën kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) e ka përgatitur informatën për gjendjen në shëndetësi të komunës sonë, duke përfshirë të dhënat bazike për secilin sektorë, numrin e vizitave të pacientëve, të arriturat, sfidat etj.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se në informatë është pasqyruar një sukses i lartë i nxënësve të shkëlqyeshëm. Ai pyeti drejtorin se a janë vërtetuar të dhënat e dërguara nga shkollat?

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se është një informatë shumë e mirë. Ajo që më ka bërë përshtypje në këtë informatë janë krahasimet që janë bërë, ku edhe e përgëzoji drejtorin për këtë informatë.

Melihate Basholli - Latifi, anëtare e KPF-së – theksoi se sukcesi në ciklin e ulët është gjithmonë më i lartë. Ajo tha se një brengë e ka shprehur edhe më herët që sukcesi vjen duke rënë, kur nxënësit vijnë duke u rritur dhe po ashtu edhe numri i mungesave vjen duke u rritur. Pastaj theksoi se është një informatë e mirë dhe gjithëpërfshirëse, si dhe kërkoi që të rritet kontrolli nëpër shkolla.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i KPF-së – kërkoi që situata në arsim të analizohet dhe drejtoria të angazhohet për rritjen e cilësisë në arsim.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe KPF-së – tha që pajtohet me atë që e tha Neziri, sepse nuk bën që të vetëkënaqemi me suksesin e nxënësve, mirëpo duhet të punohet për ngritjen e cilësisë në arsim.

Lutfi Bilalli, anëtar i KPF-së – tha që sukcesi i shkëlqyeshëm nuk e di sa përkon me realitetin, mirëpo, ajo që është brengosëse është edhe tek sukcesi i pamjaftueshëm që është 26%, që është një përqindje e lartë, në ç'rast duhet të punohet që sukcesi i nxënësve të jetë me një kualitet më të lartë.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – deklaroi se arsimi duhet të jetë prioritet i yni dhe të punojmë për ngritjen e cilësisë dhe mos të lejojmë që të na përsëriten rezultatet e dobëta të testit “PISA”.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha që informata është përpiluar shumë mirë, mirëpo, gjendja në arsim në komunën tonë nuk është në nivelin e dëshiruar. Prandaj, duhet punë, angazhim dhe koordinim i të gjitha strukturave, duke filluar nga Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, drejtorët e shkollave, mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit. Drejtoria duhet ta përcjell gjendjen nëpër shkolla se si funksionojnë organet nëpër shkolla, këshillat e shkollave, këshillat e prindërve, sepse në bazë të informatave që kemi, këto organe janë vetëm formale. Ai pyeti drejtorin se sa shkolla punojnë me kurrikulën e re; informata a është për gjysmëvjetorin e parë apo periodën e parë.

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim – deklaroi se informata mbi 90% është për gjysmëvjetorin e parë, kurse një përqindje e vogël është për periodën e parë. Shkollat që kanë qenë “pilot” e kanë përmbyllur ciklin e kurrikulës, kurse sa i përket vërtetësisë së të dhënave lidhur me suksesin e nxënësve, tha që këto të dhëna janë të vërteta, sepse nxirren edhe nga baza e të dhënave të Ministrisë së Arsimit. Ai tha se në faqen e fundit të informatës i kemi paraqitur rekomandimet, prandaj, vlerësimi është sfidë mbi sfida nëpër shkollat tonë. Sipas tij, vlerësimi i brendshëm duhet të ngrihet në nivelin e standardit të meritës.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2017.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – pyeti se cili është roli i komisionit komunal të aksionarëve.


Sedat Rashica, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike – deklaroi se fjala është për aksionet që ka komuna në ndërmarrjen “Uniteti” me rreth 28% të aksioneve. Prandaj, për shkak se mandati i anëtarëve të këtij komisioni ka skaduar në rastin e konstituimit të kuvendit të ri komunal, kemi kërkuar që kuvendi të bëjë emërimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve për mandatin aktual.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri kërkoi që të plotësohet arsyetimi me informata për rolin e komisionit, për ndërmarrjen “Uniteti”.

8. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës



Nasuf Aliu


Kryesues i KK-së dhe i KPF- së